

Datë: 17/04/2014

KONKLUZIONE

NGA

KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

‘Draft Rregullore për Autorizimet e Përgjithshme’

Dokumenti “Draft Rregullore për Autorizimet e Përgjithshme” është përgatitur në përputhje me nenet; neni 3, neni 9, paragrafi 3), neni 10, paragrafi 4), Kreu III, nenet 15, 16, 17 dhe 18 të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 dhe më datë 4 Dhjetor 2013 Bordi i Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti*) në mbledhjen LV) me radhë ka marrë vendim # 431 për miratimin e këshillimit publik të draft dokumentit (<http://www.arkep-rks.org/?cid=1,26,695>). Periudha e këshillimit publik ka zgjatur nga data 13 Dhjetor 2013 deri më datë 13 Janar 2014.

Gjatë periudhës së këshillimit publik komente kanë dërguar operatorët PTK sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC (*tutje referuar si – IPKO*):

- 1) **Komentet e PTK sh.a.;** janë dërguar më datë 13/01/2014 (*Ref. Shkresa/e-maili i datës 13 Janar 2013 4:12 PM, Nr. Prot. 029/2/14*), të cilat janë paraqitur në SHTOJCËN A) të këtij dokumenti;
- 2) **Komentet e IPKO-së;** janë dërguar më datë 13/01/2014 (*Ref. Nr. Prot. 028/2/14*) dhe gjithashtu janë dhënë sqarime shtesë në takimin e realizuar më datë 23/01/2014 me kërkesë të operatorit IPKO¹. Komentet e IPKO dhe përgjigjet e Autoritetit janë paraqitur në SHTOJCËN B) të këtij dokumenti;

Pas shqyrtimit të komenteve të prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), Bordi i Autoritetit në mbledhjen LVII) të mbajtur me datat; 03 & 04 Shkurt,2014, sipas konkluzioneve të nxjerra lidhur me pikën 2) të rendit të ditës miratoi përgjigjet, arsyetimet dhe qëndrimet e Autoritetit lidhur me dokumentin; ‘Rregullore për Autorizimet e Përgjithshme’, e cila sipas vendimit Nr. 479 është miratuar nga Bordi i Autoritetit dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja: www.arkep-rks.org.

¹ Operatori PTK sh.a. nuk e ka konsideruar si të nevojshëm organizimin e takimit për të diskutuar lidhur me komentet e dërguara.

SHTOJCA A

Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve të PTK sh.a.

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e PTK sh.a.	Përgjigja e Autoritetit
1.	<p>SHTOJCA III, 1) Përdorimi i resurseve frekuencore</p> <p>1.2 Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave, bëhet nga Autoriteti në përputhje me procedurat e specifikuara në Rregulloren për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe rregullat tjera në përputhje me Ligjin për definimin e brezeve frekuencore me rëndësi të veçantë ekonomike. Resurset frekuencore mund të përdoren vetëm pas ndarjes së tyre nga Autoriteti.</p>	<p>PTK është e mendimit se pika 1.2 duhet të jetë e formuluar si më poshtë: Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave, duhet të bëhet nga Autoriteti në përputhje të plote të Ligjit Nr.04/L-109 Për Komunikimet Elektronike, procedurave të specifikuara në Rregulloren për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe rregullat tjera në përputhje me Ligjin për definimin e brezeve frekuencore me rëndësi të veçantë ekonomike. Resurset frekuencore mund të përdoren vetëm pas ndarjes së tyre nga Autoriteti.</p>	<p>Ky paragraf modifikohet si në vijim:</p> <p><i>“Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave, bëhet nga Autoriteti në përputhje me kërkesat e Ligjit për Komunikime Elektronike Nr.04/L-109 dhe procedurat e specifikuara në Rregulloren për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe rregullat tjera në përputhje me Ligjin për definimin e brezeve frekuencore me rëndësi të veçantë ekonomike.”</i></p> <p><u>Komenti pranohet</u></p>
2.	<p>SHTOJCA III 2) Përdorimi i resurseve Numerike</p> <p>2.3 Ndërmarrësi, i cili është pajisur me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e resurseve numerike:</p> <p>f) Duhet të siguroj portabilitetin e numrave në përputhje me Rregullat e miratuara nga Autoriteti dhe atëherë kur kërkohet nga Autoriteti.</p>	<p>Për ofrimin e shërbimit të portabilitetit të numrave kërkohet që përmes Rregulloreve të Autoritetit fillimisht të sigurohet se është kryer shlyerja e borxheve të mbetura të konsumatorit tek operatori ekzistues para se të aprovohet leja për këtë shërbim. Kjo do të eliminonte mundësinë e krijimit të borxheve të mbetura të operatori ekzistues.</p>	<p>Siç është e specifikuar edhe në këtë rregullore</p> <p><i>“ndërmarrësi duhet të siguroj portabilitetin e numrave në përputhje me Rregullat e miratuara nga Autoriteti dhe atëherë kur kërkohet nga Autoriteti”</i></p> <p>Që nënkupton se të gjitha proceset lidhur me bartjen e numrave, afatin kohor, çështjet teknike dhe çështjet tjera të ndërlidhura me këtë proces do të jenë subjekt trajtimi i kësaj rregulloreje. Pra, ky paragraf në përputhje me rregullat e përgjithshme vetëm përcakton obligimin që kanë ndërmarrjet e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.</p> <p><u>Komenti Refuzohet</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e PTK sh.a.	Përgjigja e Autoritetit
3.	<p>SHTOJCA III 10) Kërkesat teknike</p> <p>10.2 Të gjithë ndërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të publikojnë specifikimet e ndërfaqeve/interfejsave të përdorura për ofrimin e shërbimeve.</p>	<p>Të gjitha ndërfaqet\interfejsat që PTK-Vala përdorë për ofrimin e shërbimeve të teknologjive të ndryshme janë në përputhje të plotë me specifikimet e standardeve të 3GPP. Duke qenë se këto të dhëna janë publike në dokumentacionet e këtij institucioni ndërkombëtar të standardizimeve, si dhe faktit që prodhuesit e pajisjeve janë të obliguar të përmbushin të gjitha rekomandimet e këtij institucioni për tu mundësuar funksionimi i pajisjeve ndërmjet prodhuesve të ndryshëm, konsiderojmë se kjo kërkesë si e tillë është e panevojshme.</p>	<p>Ky obligim është përcaktuar edhe me “Rregulloren teknike për radio pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese dhe kompatibilitetit elektromagnetik (Njohja e konformitetit)” Nr.Prot.025/B/13, prandaj ne këtë rregullore përcaktohet se operatorët janë të obliguar që të publikojnë specifikimet e ndërfaqeve/interfejsave të përdorura për ofrimin e shërbimeve.</p> <p><u>Komenti Refuzohet</u></p>
4.	<p>SHTOJCA III 15) Shërbimet e emergjencës</p> <p>15.2 Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës “112”.</p>	<p>Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e disponueshëm teknikisht për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës “112”.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm për vendosjen e personit është kërkesë në përputhje me mundësitë teknike që rrjetet publike të komunikimeve elektronike e ofrojnë një mundësi të tillë. Sido qofte për të qartësuar më tutje, në vijim është bere plotësimi i këtij paragrafi si ne vijim:</p> <p><i>15.2 Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e nevojshëm teknikisht të realizueshëm dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës “112”.</i></p> <p><u>Pjesërisht Pranohet</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e PTK sh.a.	Përgjigja e Autoritetit
5.	<p>SHTOJCA III 22) Rrezatimi Elektromagnetik</p> <p>22.1 Ndërmarrësi i autorizuar do të pajtohet me çdo standard të emetimit të rrezatimit të miratuar dhe të publikuar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>Ndërmarrësi i autorizuar do të pajtohet me çdo standard të emetimit të rrezatimit konform rekomandimeve të organizatave botërore të shëndetësisë dhe organizmave tjerë relevant në nivel ndërkombëtar të miratuara dhe të publikuara edhe në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Ky paragraf modifikohet si në vijim:</p> <p><i>“Ndërmarrësi i autorizuar do të pajtohet me çdo standard të emetimit të rrezatimit konform rekomandimeve të organizatës botërore të shëndetësisë dhe institucioneve tjera relevante si dhe standardeve tjera të miratuara dhe të publikuara në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.”</i></p> <p><u>Komenti Pranohet</u></p>
6.	<p>SHTOJCA III Neni 9, Dispozitat përfundimtare,</p> <p>2)Ndërmarrësit, të cilët posedojnë licenca individuale, janë të obliguar që brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje të dorëzojnë formularin e njoftimit tek Autoriteti. Me këtë rast këta ndërmarrës nuk janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në pikën VI të formularit të njoftimit, me përjashtim të rasteve kur ato të dhënat janë ndryshuar nga koha kur është licencuar ndërmarrja.</p>	<p>Për shkak të kompleksitetit të paraqitjes së ndryshimeve prej momentit të marrjes së licencës, kërkohet që ky afat të shtyhet për 6 muaj.</p>	<p>Edhe pse procesi i notifikimit nuk bartë në vete ndonjë angazhim të shtuar për operatorët, të cilët janë të licencuar dhe ofrojnë shërbime, megjithatë duke marrë parasysh numrin e madh të tyre, Autoriteti e konsideron si të arsyeshme kërkesën për zgjatje të afatit.</p> <p><u>Komenti Pranohet</u></p>

SHTOJCA B
Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve të IPKO-s

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-s	Përgjigja e Autoritetit
1.	<p>Neni 4 (Procedura e Njoftimit)</p> <p>1)Procedura e njoftimit nuk bart në vete kosto financiare për ndërmarrësit.</p>	<p>IPKO konsideron se kjo dispozitë duhet të specifikohet në mënyrë që të mos ketë mundësi keqinterpretimi dhe keqkuptimi. Sepse, ashtu siç është përcaktuar nënkupton se IPKO nuk do të ketë kosto financiare për procedurën e njoftimit. Andaj propozojmë që të vendoset fjalia "ARKEP nuk do të ngarkoj ndërmarrësit me asnjë kosto financiare për procedurat e njoftimit"</p>	<p>Ky paragraf ka të bëjë me kostot financiare të ndërmarrësve në raport me Autoritetin. Sidoqoftë, për të dhënë qartësinë e nevojshme, paragrafi është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>"Autoriteti nuk do të ngarkoj ndërmarrësit me asnjë kosto financiare për procedurat e njoftimit"</i></p> <p><u>Komenti Pranohet</u></p>
2.	<p>Neni 7 (Detyrimet e ndërmarrësve)</p> <p>1)Në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, ndërmarrësit janë të detyruar që të dërgojnë pranë Autoritetit të dhënat dhe raportet për veprimtarinë e tyre.</p>	<p>Neni 7.2 i draft rregullores deklaron se në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, ndërmarrësit janë të detyruar që të dërgojnë pranë Autoritetit të dhënat dhe raportet për veprimtarinë e tyre. IPKO konsideron se kjo dispozitë është në përputhje të plotë me Ligjin për Komunikime Elektronike, respektivisht pikës 3 të nenit 17 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, por meqenëse kemi të bëjmë me një akt nenligjor i cili ka të bëjë me autorizime e përgjithshme, IPKO konsideron se specifikimi i kësaj dispozite duke e tejkualuar përshkrimin e Ligjit Ligjit për Komunikimet Elektronike është në dobi të operatorëve dhe të vetë ARKEP-it sepse do të lehtësonte punën e të gjitha palëve dhe obligimet e IPKO's respektivisht operatorëve lidhur me këtë çështje do të ishin më ta qarta dhe të padiskutueshme.</p>	<p><u>Ashtu siç është theksuar edhe nga vet operatori, kjo dispozite e përfshirë në Rregullore është në përputhje të plote me Ligjin dhe nuk ka bere tejkualimin e tij. Kjo dispozite eshte perfshire ne këtë Rregullore per t'iu qartësuar operatorëve/ofruesve te shërbimeve potencial obligimet e tyre per raportim. Për me tepër ne baze te nenin 18 paragrafi 1) përcaktohet se: "Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve te komunikimeve elektronike detyrohen t'i japin te dhëna dhe çdo informacion tjetër te kërkuar nga Ministria dhe Autoriteti, ne funksion te përmbushjes se detyrave te përcaktuara nga ky Ligj" Andaj, komenti refuzohet. Të sqarohet nga RR. A.</u></p> <p><u>Komenti nuk Pranohet</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-s	Përgjigja e Autoritetit
3.	<p>Neni 9 (Dispozitat përfundimtare)</p> <p>9.2)Ndërmarrësit, të cilët posedojnë licenca individuale, janë të obliguar që brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje të dorëzojnë formularin e njoftimit tek Autoriteti. Me këtë rast këta ndërmarrës nuk janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në pikën VI të formularit të njoftimit, me përjashtim të rasteve kur ato të dhënat janë ndryshuar nga koha kur është licencuar ndërmarrja</p>	<p>Neni 9.2 i draft rregullores, obligon IPKO'n që brenda afatit tremujor pas hyrjes në fuqi të kësaj draft rregulloreje të dorëzoj formularin e njoftimit pranë Autoritetit. IPKO kondisderon se kjo dispozitë është në kundërshtim të plotë me pikën 7 të nenit 106 të Ligjit të Komunikimeve Elektronike andaj kërkon që kjo dispozitë të largohet ose të ndryshohet dhe atë në pajtim me pikën 7 të nenit 106 të Ligjit të Komunikimeve Elektronike.</p>	<p>Neni 106 paragrafi 7) përcakton si në vijim:</p> <p><i>“Licencat dhe lejet për shfrytëzim të radio-frekuencave dhe numrat e dhënë para datës së specifikuar në nenin 110 të këtij ligji duhet të konsiderohen si autorizime për t'i shfrytëzuar radio-frekuencat dhe numrat në bazë të këtij ligji dhe janë të vlefshme deri në afatin e skadimit, apo deri në afatin e ripërtëritjes.”</i></p> <p>Pra, ky nen ka të bëjë vetë me licencat/lejet/vendimet të cilat janë lëshuar nga Autoriteti për shfrytëzim të resurseve të kufizuara frekuencore dhe numerike. Dhe në këtë drejtim autorizimet individuale të lëshuara për shfrytëzim të frekuencave dhe vendimet për alokimin e numrave, nuk do të jenë subjekt trajtimi i kësaj rregulloreje, respektivisht nenit 9. Këto akte do të jenë të vlefshme deri në afatin e skadimit të tyre.</p> <p>Te gjitha licencat tjera të lëshuara nga Autoriteti për ofrim të shërbimeve dhe/ose rrjetit do ti nënshtrohen nenit 9 të kësaj rregullore dhe në rastin kur ato posedojnë edhe resurse frekuencore apo numerike (si qeshte rasti me licencën e PTK sh.a. dhe IPKO për operimin e rrjetit GSM), atëherë te gjitha nenet të cilat kanë të bëjnë me frekuenca dhe/ose numra nuk do të ndryshohen por vetëm do te pasqyrohen në një autorizim individual ne përputhje me nenin 106, paragrafi 7 të Ligjit.</p> <p><u>Komenti nuk Pranohet</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-s	Përgjigja e Autoritetit
4.			<p>Shih komentin e mësipërm</p> <p><u>Komenti nuk Pranohet</u></p>
5.			<p>Shih komentin e mësipërm</p> <p><u>Komenti nuk Pranohet</u></p>
6.			<p>Ky paragraf është plotësuar si ne vijim;</p> <p>(1) <i>Ndërmarrësit, të cilët posedojnë licenca individuale, janë të obliguar që brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje të dorëzojnë formularin e njoftimit tek Autoriteti. Me këtë rast këta ndërmarrës nuk janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në pikën I, V dhe VI të formularit të njoftimit, me përjashtim të rasteve kur ato të dhënat janë ndryshuar nga koha kur është licencuar ndërmarrja, të cilat nuk janë të parapara me raportimet periodike.</i></p> <p><i>Po ashtu, SHTOJCA I , pika I) Qëllimi i njoftimit është shtuar referenca:</i></p> <p><i>Operatorët të Licencuar sipas Ligjit për Telekomunikacion Nr.2002/7 nuk janë të obliguar që të plotësojnë pikën I, V dhe VI të Formularit të Njoftimit</i></p> <p><u>Komenti pjesërisht pranohet</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-s	Përgjigja e Autoritetit
			<p data-bbox="1270 159 1608 188">Shih komentin e mësipërm</p> <p data-bbox="1270 232 1566 261"><u>Komenti nuk Pranohet</u></p>

Ndryshimet tjera në draft rregullore:

- SHTOJCA II, titulli 'Certifikate e konfirmimit te njoftimit' është harmonizuar me LKE si ne vijim; **'Konfirmim i Njoftimit'**
- SHTOJCA I, Pika VI është plotësuar edhe me kërkesën shtesë për dorëzimin e dokumenteve; **Kopje e Certifikatës, Numrit Fiskal dhe Dokumentit 'Informatë mbi Biznesin'**